

## VKM

**Nr. 407, date 29.8.2002**

### **PER MENYREN E TRAJTIMIT ME STREHIM TE INVALIDEVE PARAPLEGJIKE DHE TETRAPLEGJIKE**

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, te neneve 3, 17 dhe 21 te ligjit nr.8626, date 22.6.2000 "Për statusin e invalidëve paraplegjike e tetraplegjike" dhe te neneve 1 e 13 te ligjit nr. 8030, date 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", me propozimin e Ministrit te Rregullimit te Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit te planifikoje fonde për te pastrehët me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, ne baze te kërkesave qe organet e qeverisjes vendore i dërgojnë Entit Kombëtar te Banesave, brenda datës 1 gusht te çdo viti.
2. Organet e qeverisjes vendore t'u japin ne çdo kohe statusin e te pastrehut invalidëve qe përcaktohen te tille ngakomisionet mjekësore te caktimit te aftësisë për pune dhe qe marrin "Dëshmi zyrtare identifikimi" nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.
3. Përparësi ne dhënien e statusit te te pastrehut dhe ne trajtimin me strehim nga shteti, ne mbështetje te nenit 12 te ligjit nr.8030, date 15.11.1995, kane rastet kur:
  - a) familja, kryefamiljari i se cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, banon ne mjedise qe nuk janë fond banese;
  - b) familja, kryefamiljari i se cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, zotëron sipërfaqe banimi me pak se normat e strehimit ne fuqi;
  - c) familja, një pjesëtar i se cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, banon ne sipërfaqe nen normat e strehimit ne fuqi dhe është ne gjendje te vështire ekonomike.
4. Shpenzimet e Entit Kombëtar te Banesave përballohen nga Buxheti i Shtetit ne rastet kur: a) individi i pastrehe, me statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, është kryefamiljar; b) familja, qe ka ne përbërje një pjesëtar me statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, ka te ardhura për fryme me pak se 6 000 (gjashte mije) leke ne muaj .
5. Qendër banimi për individët qe kane përfituar nga statusi i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik merret qendra ku ata kane përfituar statusin e te pastrehut.
6. Ne qytetet, ku vlera e banesave ne treg është me e vogël se kostoja mesatare e ndërtimit te banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, apartamentet te blihen, për invalidin paraplegjik ose tetraplegjik, ne katet e para te banesave tip, sipas kriterëve te përcaktuara ne vendimin nr.286, date 2.6.2000 te Këshillit te Ministrave, "Për kriteret e blerjes dhe shitjes se apartamenteve nga Enti Kombëtar i Banesave ne tregun e lire te banesave". Kur, me pëlqimin e familjes, apartamenti blihet ne banesa te pajisura me ashensorë, diferenca

ndërmjet vlerës se apartamentit me fondin limit te blerjes, sipas vendimit nr .286, date 2.6.2000 te Këshillit te Ministrave, shlyhet nga qytetari i pastrehe.

7. Ne qytetet ku vlere e apartamenteve ne treg është me e larte se kostoja mesatare e ndërtimit ty banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe ky i fundit nuk investon ne ndërtime te reja, qytetari me statusin e invalidit paraplegjik a tetraplegjik ose familja e tij përfiton nga tregu i lire i banesave. Ne këtë rast, Enti Kombëtar i Banesave me paraqitjen e kontratës se shitblerjes se apartamentit ndërmjet qytetarit te pastrehe dhe shitësit te apartamentit, shlyen vlerën, e cila është e barabarte me vlerën limit te apartamentit qe përfiton familja. Diferenca ndërmjet vlerës se apartamentit te blere ne treg me fondin limit te apartamentit, shlyhet nga vete familja e pastrehe.

8. Ne te gjitha rastet e parashikuara ne pikat 5 dhe 6 te këtij vendimi, vlere limit e apartamentit qe përfiton qytetari i pastrehe shlyhet pranë Entit Kombëtar te Banesave, sipas kriterëve te përcaktuara ne ligjin nr.8030, date 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" dhe akteve nënligjore ne zbatim te tij.

9. Deri ne hartimin e normave te projektimit te godinave te banimit për kategoritë me kërkesa te veçanta, te përdoren katet e para te godinave, qe do te ndërtohen ose blihen nga Enti Kombëtar i Banesave, për trajtimin e personave sipas pikave 5 dhe 6 te këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

Fatos Nano